





# Vlerësimi i nxënësve përmes platformave digjitale

Manual për shkollat profesionale



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

 Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:



Zbatuar nga:

  
swisscontact

Ky publikim është prodhuar nga projekti “Aftësi për Punë” (S4J) nën mbikqyrjen e Prof. Asoc. Dr. Erka Çaro, Zv. Menaxhere Projekti dhe Eriola Shingjergji, Menaxhere e Linjës për Digjitalizimin në AFP.

### **Autore**

Prof. Asoc. Dr. Sonila Papathimiu

### **Kontributore**

Ermira Mani

Irena Majko

Megi Duçi

Rafaela Kolaj

Rudina Gjoka

*Me mbështetjen e Pamela Meta*

### **Rreth projektit “Aftësi për Punë” (S4J)**

Aftësi për Punë (S4J) është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) i zbatuar nga Swisscontact, i cili synon të adresojë sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri. Që prej tetorit 2015, projekti “Aftësi për Punë” (S4J) mbështet qeverinë dhe aktorët e tjerë të interesit për të ndërtuar një sistem cilësor të AFP në Shqipëri, i frymëzuar nga modeli zviceran. Në fazën e tij të tretë (2024-2027), me theks të veçantë tek qëndrueshmëria, projekti është angazhuar në ndarjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive dhe përvojave të përfutuara në nivel sistemi, në bashkëpunim të ngushtë me shkollat partnere.

### **Pronësia intelektuale**

© Ky publikim është pronësi ekskluzive intelektuale e projektit “Aftësi për Punë” (S4J). Publikimi mund të aksesohet, lexohet, shkarkohet apo printohet vetëm për përdorim personal. Ndalohet riprodhimi, shpërndarja, shitja, shfaqja, ndryshimi apo përshtatja e çdo materiali që përfshihet në publikim pa autorizim nga S4J.

**Shënim:** Pikëpamjet dhe konkluzionet e shprehura në këtë publikim nuk paraqesin domosdoshmërisht pozicionin zyrtar të Qeverisë Zvicerane ose Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

## Tabela e përmbajtjes

Hyrje .....	2
I. Përdorimi i platformave për vlerësimin e nxënësve .....	3
I.1. Çfarë është vlerësimi digjital dhe rëndësia e tij në mësimdhënien bashkëkohore .....	3
I.2. Pse duhet të përdoren platformat për vlerësimin e nxënësve?.....	3
I.3. Avantazhet e përdorimit të platformave për vlerësimin e nxënësve.....	4
I.4. Disavantazhet e përdorimit të platformave për vlerësimin e nxënësve .....	5
I.5. Si të zgjedh platformën më të përshtatshme për vlerësimin e nxënësve? .....	6
I.6. Përgatitja e Librit të vlerësimit .....	8
I.7. Raste suksesi në përdorimin e platformave për vlerësimin e nxënësve .....	10
II. Përdorimi i platformës Mësovet për vlerësimin e vazhduar të nxënësve.....	10
II.1. Pse Mësovet është zgjedhja më e mirë për vlerësimin digjital .....	10
II.2. Aftësitë e nevojshme digjitale të mësuesve për vlerësimin me anë të Mësovet.....	11
II.3. Përzgjedhja dhe krijimi i veprimtarive mësimore për vlerësimin e vazhduar (Forume, kuice, teste, detyra) .....	11
III. Banka e pyetjeve në Mësovet dhe përdorimet e saj.....	14
III.1. Çfarë është banka e pyetjeve në një platformë digjitale? <i>Avantazhet e përdorimit</i> .....	14
III.2. Llojet e pyetjeve për vlerësimin digjital.....	18
III.3. Hartimi i pyetjeve që shmangin kopjimin në vlerësimin digjital .....	19
IV. Përdorimi i platformës Mësovet nga nxënësit për realizimin e veprimtarive të ndryshme me vlerësim .....	20
IV.1. Hapja e aktiviteteve të ndryshme në Platformë dhe dorëzimi i tyre .....	20
IV.2. Zhvillimi i testeve në Platformë dhe dorëzimi i tyre. ....	21
IV.3. Kontrolli i vlerësimeve individuale në platformë .....	21
V. Pyetje të shpeshta.....	22
Burimet e përdorura:.....	23

## Hyrje

Mësimdhënia po përballlet çdo ditë e më shumë me ndryshime e sfida të reja, të diktuar nga përparimi teknologjik dhe digjitalizimi i jetës në tërësi. Është shumë e rëndësishme që sektori i edukimit, t'i përgjigjet në kohë këtyre sfidave dhe të ndryshojë qasjen ndaj brezit të ri në shumë drejtime. Nxitja për përdorimin e metodave bashkëkohore në mësim, kërkon rritjen e përdorimit të platformave dhe aplikacioneve digjitale, të cilat janë burimet kryesore të materialeve mësimore në formate të ndryshme: video; imazhe; ilustrime; harta mendore etj. Ato lehtësojnë punën e mësuesit, rrisin ndërveprimin si dhe përfshirjen e interesin për mësimin në përgjithësi. Në këtë kuadër, një element i rëndësishëm i mësimdhënies është edhe vlerësimi i ecurisë së nxënësve në perioda të ndryshme të vitit shkollor me anë të detyrave, projekteve, kuiceve të shkurtra apo teste përsëritëse.

Imagjinoni një mësues/e, i cili jep mësim në të paktën 3 klasa paralele me mbi 30 nxënës nga dy orë në javë. Për të pasur një vlerësim gjithëpërfshirës të ecurisë së nxënësve gjatë gjithë tremujorit dhe në përfundim të lëndës, mësuesi/ja ka parashikuar nga një detyrë me shkrim çdo dy orë mësimore, nga një kuic të shkurtër çdo tre tema, një projekt lëndor të ndarë me rubrika që duhen vlerësuar dhe nga një test përsëritës në fund të çdo tremujori. Sa e lehtë apo e vështirë do jetë për këtë mësues/e të menaxhojë mbajtjen e fletoreve, projekteve, fletave të testeve etj., korrigjimin e tyre, sistemimin e shënimeve, përlllogaritjen e vlerës specifike të tyre në vlerësimin përfundimtar etj. Ky skenar në fakt është realiteti i shumicës së mësuesve në Shqipëri, të cilët përballojnë lodhje të shumta për të arritur në një vlerësim të drejtë, të barabartë dhe gjithëpërfshirës për nxënësit e tyre.

Ky Manual është konceptuar dhe hartuar duke pasur në mendje pikërisht këtë realitet dhe përpiket tu përgjigjet shumicës së sfidave të sipërpërmendura. Ai u vjen në ndihmë të gjithë mësuesve që duan tu përshtaten ndryshimeve dhe të lehtësojnë punën e tyre me anë të përdorimit të vlerësimit digjital.

Në këtë Manual trajtohet në tërësi vlerësimi i i nxënësve përmes platformave digjitale duke nisur nga prezantimi teorik i vlerësimit digjital si koncept, rëndësisë së përdorimit të tij, avantazheve dhe disavantazheve, deri tek te aspekti praktik, që synon t'i aftësojë mësuesit për ta aplikuar atë në lëndët e tyre, të njohin dhe përdorin platformat dhe aplikacionet që ofrojnë vlerësim digjital, të identifikojnë dhe krijojnë aktivitete mësimore të përshtatshme për vlerësimin digjital, të përftojnë dhe analizojnë rezultatet e gatshme nga platformat etj. Një rëndësi e veçantë, në Manual, i është kushtuar platformës Mësovet, si një platformë e përshtatshme për vlerësimin digjital me një sërë përfitimesh që trajtohen në vijim. Me një fjalë, manuali ka si qëllim aftësimin teorik dhe praktik të mësuesve mbi përdorimin e vlerësimit digjital, me anë të teksteve shpjeguese, grafikëve, skemave e ilustrimeve, si dhe videove tutoriale.

Vlen për tu theksuar se ekspertët e S4J janë konsultuar gjerësisht mbi këtë manual me mësues dhe drejtues të shkollave profesionale që janë specialistë të vlerësimit përmes platformave digjitale. Si rezultat i këtyre konsultimeve, është hartuar fillimisht struktura dhe më pas përmbajtja e manualit. Me shumë vlerë kanë qenë rekomandimet e grupeve të konsultimit për sfidat kryesore që hasin mësuesit në zbatimin praktik të këtyre teknikave. Ju ftojme të na bashkoheni në këtë rrugëtim!

## **I. Përdorimi i platformave për vlerësimin e nxënësve**

### **I.1. Çfarë është vlerësimi digjital dhe rëndësia e tij në mësimdhënien bashkëkohore**

#### *I.1.a. Vlerësimi digjital si koncept dhe qëllimi i përdorimit*

Përdorimi i teknologjisë dhe digjitalizimi në përgjithësi kanë njohur një rritje marramendëse dhe përmirësim të vazhdueshëm që prej Pandemisë Covid-19. Në këtë kontekst po transformohet dhe përshtatet dita ditës edhe sistemi arsimor dhe procesi mësimdhënies e mësimnxënies. Fokusi i edukimit po zhvendoset nga thjesht grumbullimi i materialit studimor tek shtimi i analizave dhe shprehjes së mendimit kritik të nxënësve.

Vlerësimi digjital, i njohur ndryshe si e-Vlerësimi (vlerësimi elektronik) nënkupton shpërndarjen e testeve, pyetësorëve dhe materialeve të tjera nëpërmjet platformave apo aplikacioneve përmes pajisjeve digjitale si: kompjuter, tablet, smartphone) etj., të cilat në shumicën e rasteve korrigjohen automatikisht. Për funksionimin e tyre, zakonisht duhet të përdoret teknologji shtesë si: internet ose intranet etj.

Qëllimi kryesor i vlerësimit digjital është shpërndarja e kuiceve, pyetësorëve, sondazheve apo testeve dhe sigurimi i rezultateve më lehtë, në një kohë më të shkurtër dhe që orientojnë mësuesin për përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.

#### *I.1.b. Rëndësia e përdorimit të vlerësimit digjital*

Rëndësia e Vlerësimit digjital qëndron në faktin se krijon mundësi për mësuesit që të gjurmojnë përparimin e nxënësve duke identifikuar më lehtë dhe shpejtë pikat e forta dhe nevojat për përmirësim të tyre. Raportet mbi ecurinë e përgjithshme ose individuale të nxënësve hartohen lehtësisht dhe kjo gjë i ndihmon mësuesit të përshtatin mësimdhënien në varësi të kërkesave dhe ecurisë së nxënësve.

Në mësimdhënien bashkëkohore është e rëndësishme gjithëpërfshirja, nxitja e mendimit kritik, debatit, ndërveprimit me mësuesin dhe shokët e klasës etj. dhe mbi të gjitha përmbushja e nevojave individuale të nxënësve. Me anë të vlerësimit digjital të realizuar nëpërmjet kuiceve të shkurtra, forumeve, diskutimeve, testeve përsëritës etj. mësuesi kontribuon në gjithëpërfshirjen e nxënësve, edhe të atyre që do të nguronin të përgjigjeshin përpara klasës dhe mbi të gjitha, sigurohet edhe personalizim dhe mësim më efektiv për të gjithë.

### **I.2. Pse duhet të përdoren platformat për vlerësimin e nxënësve?**

Në punën e përditshme, mësuesit kanë shumë angazhime dhe detyrime, për të cilat kërkohet kohë dhe energji. Një nga këto është edhe korrigjimi i detyrave të nxënësve, testeve, kuiceve etj. Vlerësimi digjital automatik lehtëson punën e mësuesit dhe rrit besimin e nxënësve për saktësinë dhe barazinë në vlerësim. Përveç kësaj, vlerësimi digjital lehtëson përlllogaritje të ndryshme në funksion të vendosjes së notës për nxënësit. Mësuesit mund të shkarkojnë raportet e vlerësimit, të krijojnë grafikë dhe të identifikojnë më shpejt dhe lehtë nxënësit që nuk kanë ecuri të mirë si dhe temat ose kapitujt më problematikë. Kjo ndikon në përmirësimin e punës së tyre, që në të ardhmen të fokusohen më shumë në ato tema për të cilat nxënësit kanë shfaqur vështirësi.

Për të realizuar si duhet vlerësimin digjital është e nevojshme përdorimi i teknologjisë moderne dhe aplikacioneve apo platformave digjitale. Në mënyrë që ato të jenë lehtësisht të përdorshme dhe të funksionojnë sipas kërkesave të përdoruesve (kryesisht mësuesit dhe nxënësit), zakonisht përzgjidhen platforma të bazuara në Cloud, pasi ato sigurojnë më shumë shërbime, sesa thjesht shpërndarja digjitale e testeve.

### **I.3. Avantazhet e përdorimit të platformave për vlerësimin e nxënësve**

#### *I.3.a. Përdorim i thjeshtë në çdo vend dhe kohë*

Përdorimi i vlerësimit digjital është përgjithësisht i lehtë si për mësuesit ashtu edhe për nxënësit. Ai mund të përdoret kudo dhe kurdo, mjafton të keni pajisjet digjitale dhe linjë interneti në to. Mësuesit mund të krijojnë lehtësisht teste, kuice, sondazhe etj. dhe tua dërgojnë nxënësve, të cilët marrin vlerësimin/rezultatit menjëherë sapo e dorëzojnë online. Ky ndërveprim mund të ndodhë edhe kur mësuesit dhe nxënësit nuk janë fizikisht në klasë.

#### *I.3.b. Vlerësim i saktë*

Vlerësimi digjital siguron saktësi dhe barazi në korigjim. Platformat digjitale që përdoren për vlerësim kanë të gjithë elementët e duhur për të siguruar rezultate të sakta dhe kjo i bën edhe nxënësit më të prirur për të pranuar rezultatet. Kjo ndikon edhe në rritjen e qëndrimit dhe mendimit pozitiv ndaj mësuesve dhe institucionit, duke ndërtuar besim të fortë midis nxënësve dhe mësuesve.

Gjithashtu, raportet e krijuara në platformë i orientojnë mësuesit që të identifikojnë me shpejt fushat problematike të të nxënësve në nivelin individual dhe në grup. Nxënësit marrin rezultatet menjëherë në platformë, sapo kanë mbaruar dhe janë më të vetëdijshëm për pikat e tyre të forta dhe aty ku kanë nevojë për përmirësim.

#### *I.3.c. Përfitime të ndryshme*

Kryerja e provimeve në internet, është shumë praktike dhe sjell përfitime të ndryshme si për mësuesit, ashtu edhe për nxënësit. duket shumë praktike pasi nuk ka nevojë të printohen pyetje të panumërta, të përfshihet i gjithë stafi i shkollës në organizimin e procedurave, të caktohen mbikëqyrës, të ftohen qindra nxënës në klasa të bollshme për të bërë teste dhe t'u sigurohet atyre fletë përgjigjesh dhe materiale plotësuese. Kështu, fleksibiliteti i kohës dhe vendit të zhvillimit, ulja e kostove njerëzore, logjistike dhe administrative i japin përparësi të konsiderueshme Vlerësimit digjital kundrejt zhvillimit tradicional të testeve.

#### *I.3.d. Ndhomon në mbrojtjen e mjedisit*

Zhvillimi i provimeve online, sidomos i testeve të shkurtra që janë më të shpeshta, është shumë praktik pasi nuk është e nevojshme të printojmë teza të shumta që shtojnë përdorimin e letrës dhe të shpenzimeve monetare. Përdorimi i platformave për vlerësimin digjital i eleminon këto shpenzime dhe mund të realizohet në çdo kohë dhe vend.

#### *I.3.e. Vetëkorigjim i shpejtë*

Një avantazh i rëndësishëm i vlerësimit digjital është sigurisht korigjimi i automatizuar, i cili minimizon gabimet njerëzore dhe shkurton kohën e dhënies së rezultateve. Platformat që ofrojnë sistemin e vlerësimit digjital përballojnë korigjime të menjëhershme, pavarësisht numrit të përgjigjeve të dhëna në të njëjtën kohë. Nxënësve nuk u duhet të presin disa ditë për rezultatet e tyre

(në rastin e testeve apo kuiceve vetëm me alternativa) duke bërë të mundur që të kuptojnë më shpejt se ku kanë mangësi dhe ku duhet të përqendrohen për të mësuar në të ardhmen.

Rritja e kërkesave për të përfshirë edhe pyetje formuese dhe analitike për nxënësit në testime të ndryshme, kërkon që në të ardhmen platformat e vlerësimit digjital të përfshijnë module komplekse për vlerësimin e ese-ve dhe pyetjeve të tilla, gjë që do të shtonte rëndësinë dhe përdorimin e vlerësimit digjital nga mësuesit.

#### *1.3.f. Menaxhim efikas i kohës*

Përgatitja e testeve apo kuiceve të ndryshme kërkon kohë dhe shpesh kthehet në një proces të mërzitshëm për mësuesit. Në rastet kur ato janë në kopje fizike përfshihen një seri aktiviteteve si printimi i tezave, fotokopjimi, shpërndarja, mbledhja, korrigjimi me radhë etj. Vlerësimi digjital lehtëson mësuesit nga kjo mori aktiviteteve, duke kursyer kohë dhe shpenzime të tjera.

### **1.4. Disavantazhet e përdorimit të platformave për vlerësimin e nxënësve**

#### *1.4.a. Vështirësi në vlerësimin e pyetjeve me shtjellim (ose të gjata)*

Vlerësimi digjital është shumë efikas përse i përket testeve, kuiceve apo sondazheve me pyetje me alternativa, zgjedhje të shumëfishta etj., por vlerësimi i pyetjeve me shtjellim mbetet akoma një sfidë për të. Vlerësimi elektronik nuk është shumë efikas për këto pyetje, pasi kërkojnë vlerësim nga mësuesi dhe shënim të pikëve prej tyre. Këto vështirësi në disa platforma që përdoren për vlerësim kanë filluar të përballohen duke përdorur Inteligjencën Artificiale, e cila ndihmon në vlerësim me anë të vendosjes së fjalëve kyçe dhe parametrave të tjera për vlerësimin. Pavarësisht kësaj, vlerësimi i pyetjeve me shtjellim vazhdon të mbetet një sfidë i vlerësimit digjital.

#### *1.4.b. Kërkon shumë punë fillestare për ta përshtatur*

Për të zbatuar si duhet vlerësimin digjital, është e nevojshme që mësuesit të punojnë për të përshtatur pyetjet dhe kërkesat e ndryshme sipas kushteve të reja. E rëndësishme është që të trajnohen mësuesit për kriteret e formulimit të pyetjeve sipas formatit që kërkohet nga platformat vlerësuese, por edhe për të matur si duhet njohuritë e nxënësve dhe të nxitet mendimi kritik.

#### *1.4.c. Shfaqen pengesa infrastrukturore dhe të sigurisë së të dhënave*

Infrastruktura digjitale, mundësia e përdorimit të internetit, pajisjeve elektronike etj. janë disa nga problemet me të cilat përballen mësuesit dhe nxënësit gjatë përdorimit të vlerësimit digjital. Në vendet në zhvillim që kanë probleme me furnizimin me energji elektrike, shpejtësi të ulët të internetit, mungesë të pajisjeve elektronike në klasë për të gjithë etj. vlerësimi digjital është shumë problematik dhe sfidues, aq sa shumë mësues mund të heqin dorë prej tij.

Problem tjetër që lidhet me këtë ka të bëjë me faktin se sistemet e informacionit nëpërmjet internetit janë të çënueshme dhe shpesh mund të bien pre piratëve elektronik, që mund të kopjojnë pyetjet, tezat, kuicet etj. dhe t'i shpërndajnë ato pa leje.

*Së fundi*, përdorimi i Vlerësimit digjital ashtu si çdo tjetër që përdorim në jetën e përditshme dhe në mësimdhënie ka avantazhet dhe disavantazhet e veta. Pavarësisht lehtësirave që ofron teknologjia

në këtë proces, ajo ende ka disa kufizime, që duhen tejkaluar. Vështirësitë mund të tejkalohen fillimisht duke i identifikuar e më pas duke përzgjedhur me kujdes metodologjinë dhe infrastrukturën e duhur. Koha kërkon që të kalohet në përdorim më të gjerë të vlerësimit digjital, sepse përfitimet prej përdorimit të tij janë shumë më tepër sesa të vështirësitë ose të metat që paraqiten.

### **1.5. Si të zgjedh platformën më të përshtatshme për vlerësimin e nxënësve?**

Zhvillimi i teknologjisë ka ndikuar në shtimin e platformave dhe aplikacione që ofrojnë mundësi për krijimin e testeve të llojeve të ndryshme dhe vlerësimin e tyre në kohë reale. Ky fakt mund të shihet si një avantazh i madh i mësimdhënies bashkëkohore, por nga ana tjetër mund të krijojë konfuzion dhe çoroditje për mësuesit dhe nxënësit. Mësuesit vendosen përpara dilemës se cila do të ishte platforma më e mirë për ta dhe se çfarë duhet të kenë parasysh kur zgjedhin se cilën do përdorin? Në këtë sesion do të rendisim disa platforma të menaxhimit të mësimin të cilat ofrojnë edhe mundësinë e krijimit, shpërndarjes dhe vlerësimit digjital të detyrave, kuiceve, forumeve etj. si dhe elementët që e bëjnë një platformë të tillë të preferueshme për tu përdorur nga mësuesit ose jo.

#### *1.5.a. Platforma Mësovet për vlerësimin digjital të nxënësve*

Platforma Mësovet është një platformë e menaxhimit të mësimin, e cila përdoret në disa shkolla të mesme profesionale në Shqipëri. Kjo platformë ofron shumë mundësira për mësuesit dhe menaxhimin e mësimdhënies, organizimin e lëndëve sipas shkollave përkatëse, mundësinë për të modifikuar lëndët tashmë të krijuara dhe me materiale e aktivitete të gatshme etj. Një nga mundësitë që ofron Mësovet është edhe përdorimi i saj për të realizuar vlerësimin e nxënësve dhe përlllogaritjen e shpejtë të pikëve të grumbulluara prej tyre dhe konvertimin në notë.

Në lëndët që janë të gatshme në Mësovet, mësuesit Për çdo aktivitet që mësuesi krijon dhe e pikëzon (i vendos një vlerësim dhe e përfshin në librin e notave (gradebook) vlerësimi ose rezultati i tij vendoset automatikisht edhe në librin e notave.


*Për shembull:* Kur mësuesi krijon një kuic të shkurtër përsëritës për mësimin e ditës dhe e klasifikon si një aktivitet me vlerësim (pikëzim) brenda një kategorie tjetër vlerësuese, që mund të jetë Kuice të shkurtra përmbledhje, pikët e marra nga nxënësi vendosen automatikisht në librin e notave dhe përlllogaritjet e tjera bëhen nga sistemi.

#### *1.5.b. Platforma Moodle për vlerësimin digjital të nxënësve*

Platforma Moodle, ashtu si dhe Mësovet, është një platformë e menaxhimit të mësimin dhe ka përdorim të gjerë në shumë Universitete e shkolla jashtë Shqipërisë si dhe në disa shqiptare. Përveç shumë mundësive që ajo ofron për organizimin e lëndëve në një mjedis digjital dhe shtimin e materialeve të shumta në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, në të realizohet vlerësimi i nxënësve me anë të aktiviteteve të shumta që ofron vetë platforma. Për çdo aktivitet që mësuesi krijon dhe e pikëzon (i vendos një vlerësim dhe e përfshin në librin e notave (gradebook) vlerësimi ose rezultati i tij vendoset automatikisht edhe në librin e notave.

*Për shembull:* Mësuesi krijon një forum diskutimi për mësimin e ditës dhe e klasifikon si një aktivitet me vlerësim (pikëzim) brenda një kategorie tjetër vlerësuese, që mund të jetë forume diskutimi përmbledhje. Pikët e marra nga nxënësi vendosen automatikisht në librin e notave dhe përlllogaritjet e tjera bëhen nga sistemi.





Në tabelën e mësipërme janë disa nga veprimtaritë që mund të shtohen në një lëndë të caktuar dhe që mund të klasifikohen si pjesë të vlerësimit të vazhduar të nxënësit. Mësuesi ka mundësi të alternojë lloje të ndryshme veprimtarish dhe tu vendosi atyre peshën përkatëse në vlerësimin përfundimtar. Platforma Moodle, gjithashtu të ofron mundësinë e ndjekjes së ecures individuale të nxënësve, shkarkimin e vlerësimeve në formate të ndryshme dhe paraqitjen grafike të rezultateve, të cilat ndihmojnë mësuesit në analizat për lëndën në çdo moment gjatë vitit shkollor.

### *1.5.c. Platforma Google classroom për vlerësimin digjital të nxënësve*

Vlerësimi i nxënësve është i mundur edhe në platformën Google Classroom, e cila është një platformë që filloi të kishte një përdorim të gjerë gjatë pandemisë. Ashtu si edhe Moodle e Mësoret të përmendura më lart, edhe kjo platformë ofron një sërë mjetesh dhe aktiviteteve që mund tu vendosen vlerësime me pikë, për të matur njohuritë e nxënësve dhe ecurinë e përgjithshme të tyre. Disa aktivitete të tilla që gjenden dhe përdoren në Google Classroom janë: Detyrat, kuicet e shkurtra, testet, projektet dhe aktivitete të tjera janë lehtësisht të përdorshme në Classroom dhe ndihmojnë mësuesit për të korrigjuar lehtë dhe shpejt një pjesë të tyre, për t'i pasur të gjitha vlerësimet të mbledhura në të njëjtën platformë.

Gjatë procesit të vlerësimit mësuesi siguron të dhëna mbi aftësinë e nxënësve për të arritur objektivat mësimor, nivelin e përfshirjes, cilësisë së punës, aftësitë për të mësuar vetë dhe aftësitë bashkëpunuese. Gjithashtu, nëpërmjet platformës dhe duke raporte dhe përmbledhje të qarta të ecures së secilit nxënës, mësuesi e ka më të lehtë të identifikojë pikat e forta e nevojat e tyre për zhvillim dhe të organizojë planin mësimor në të ardhmen në bazë të këtyre rezultateve. Të tre platformat e listuara më lart janë shumë të vlefshme dhe ofrojnë disa lloje aktiviteteve që mund të përdoren nga mësuesi për vlerësimin e njohurive të fituara nga nxënësit.

Disa elementë që duhet të mbahen parasysh nga mësuesit për të përzgjedhur platformën që do përdorin për vlerësimin e nxënësve janë:

- *Gjuha e platformës.* Tendanca është që të përzgjidhet platforma që është në gjuhën amtare. Në këtë rast avantazhin e ka Mësovet.al
- *Lehtësia e përdorimit;* Mësuesit tentojnë të zgjedhin platformat që janë më shumë miqësore me përdoruesin dhe të lehta në komanda dhe ekzekutime. Në këtë rast më e preferueshme është Goolge Classroom;
- *Larmishmëria dhe lehtësia e shtimit të aktiviteteve me vlerësim;* Përfshirja e nxënësve në mësim dhe rritja e ndërveprimit realizohet më mirë në platformat me lloje të ndryshme aktiviteteve me vlerësim. Në këtë rast platformat që i plotësojnë këto kushte janë: Mësovet dhe Moodle.
- *Mundësia e kategorizimit të aktiviteteve me vlerësim dhe përcaktimit të peshës së tyre në vlerësimin përfundimtar:* Kjo gjë realizohet më mirë në platformat Mësovet dhe Moodle. Google classroom ofron një mundësi të tillë, por është shumë i thjeshtë.
- *Paraqitja e rezultateve në forma të ndryshme dhe grafike:* Kjo mund të realizohet në të tre platformat.
- *Mundësia e krijimit të grupeve dhe vlerësimit të tyre automatikisht:* Ky opsion është i mundur vetëm në platformat Mësovet dhe Moodle.
- *Gjuha e përdorimit:* Nga të tre platformat e shpjeguara vetëm Mësovet është në shqip dhe shton avantazhet për tu përdorur nga një grup më i madh mësuesish.


## **I.6. Përgatitja e Librit të vlerësimit**

*I.6.a. Vendosja e formulave paraprake për vlerësimet e ndryshme dhe konvertimi i përqindjeve në nota.*

Platformat Mësovet dhe Moodle ofrojnë mundësinë e vendosjes paraprakisht të përqindjeve për çdo kategori që do të përfshihet në përlllogaritjen e vlerësimit përfundimtar. Kjo gjë mund të realizohet edhe në Google Classroom, por në këtë rast kategorizimi me përqindje është më i thjeshtë dhe nuk të jep mundësi që të përfshihet të gjitha vlerësimet në përlllogaritjen përfundimtare.

Në Mësovet, mësuesit mund të vendosin përcaktimet paraprake në librin e notave (Gradebook) për të realizuar përlllogaritjen automatike të të gjitha veprimtarive me vlerësim (detyra, kuice, teste, forume etj.) të krijuara në platformë. Në këtë pjesë të Manualit do të shpjegohet se si të realizohet kjo gjë dhe si të përdoret në lëndët në platformë.

Për të realizuar vlerësimin përfundimtar të nxënësve me anë të pikëve/përqindjeve të grumbulluara gjatë gjithë vitit krijojmë një sistem të përbashkët vlerësimi të përbërë nga kategori me vlerësim të ponderuar. Në një sistem të tillë vlerësimi, pikët e grumbulluara nga veprimtari të ndryshme do të kenë të paracaktuar “peshën” që do të kenë në vlerësimin përfundimtar, që duhet të reflektojë rëndësinë relative të tyre në përcaktimin e notës përfundimtare. *Për shembull*, nëse pikët e grumbulluara nga provimet e tremujorëve kanë rëndësi më të madhe në vlerësimin përfundimtar, atëherë pa dyshim që do krijohet një kategori e veçantë vlerësimi me emërtimin Provimet e tremujorit, së cilës do i përcaktohet ‘pesha’ 50%. Pjesa tjetër prej 50% të vlerësimit do të ndahet midis kategorive të tjera, përsëri sipas rëndësisë që kanë për vlerësimin përfundimtar të nxënësve.



Në raste të tjera mund t'i jepet më shumë rëndësi, “peshë”, vlerësimit nga aktivitete të tjera gjatë vitit shkollor dhe të krijohet një formulë më gjithëpërfshirëse, për të mos krijuar mundësinë, që nxënësit t'i përkushtohen më shumë njëjës kategori vlerësimi (në rastin e mësipërm provimeve të tremujorit) dhe të anashkalojnë të tjerat.

Qëllimi i vlerësimit digjital është pikërisht ky, që duke lehtësuar përlllogaritjen përfundimtare të notës, tu krijojë mësuesve mundësinë e shtimit të sa më shumë aktiviteteve dhe shpërndarjen e vlerësimit gjatë gjithë vitit. Në këtë rast ne shpërblejmë indirekt edhe këmbënguljen e nxënësve, përkushtimin gjatë gjithë vitit, zhvillimin e mendimit kritik dhe rrisim besimin në një vlerësim të drejtë dhe të barabartë.

*Për shembull*, një ndarje më balancuar e vlerësimit sipas kategorive të ponderuara, për mos t'i mbajtur shpresat vetëm te provimet e tremujorit, ku është edhe rreziku që nxënësit që kopjojnë arrijnë rezultate më të larta sesa ata që punojnë e janë të ndershëm në provim do të ishte:

- *Detyrat 25%*
- *Projektet 25%*
- *Pjesëmarrja në forume 15%*
- *Kuice të shkurtra 15%*
- *Provime të tremujorit 20%*

Pasi kemi krijuar këto kategori në lëndën përkatëse në Mësovet, kemi përcaktuar peshën e secilës etj. atëherë mjafton të klikojmë mbi “Vlerësimet” dhe na shfaqen vlerësimet për çdo nxënë.

Platforma i ka automatikisht çdo përqindje me Shkronjën përkatëse të vlerësimit, sipas vlerësimit amerikan, pra me A+, A, B+, B etj., megjithatë kjo nuk përbën ndonjë problem, sepse çdo mësues mund të modifikojë vetë dhe të vendosi notën përkatëse në vend të shkronjës.

#### Video tutorial:

- [Modifikimi i shkronjave në nota në vlerësim.](#)

## **I.7. Raste sukcesi në përdorimin e platformave për vlerësimin e nxënësve**

Një nga praktikat më të spikatura të përdorimit të vlerësimit digjital në shkollat profesionale që kanë bashkëpunuar në vite me S4J, është realizimi i provimeve teorike të nivelit përmes platformës MësoVET. Siç vepohet edhe për provimet në letër, mësuesit hartojnë teste të personalizuar që përfshijnë pyetje me alternativa dhe detyra praktike që reflektojnë aftësitë e nevojshme për tregun e punës. Më pas, këto bankë pyetjesh ngarkohen në Mësovet dhe nën mbikëqyrjen e mësuesve, nxënësit kryejnë në klasë testimin përmes platformës në kompjutera apo tableta të shkollës.

Sipas stafit të shkollave profesionale që realizojnë provimet përmes Mësovet, kjo metodë e vlerësimit digjital ka sjellë disa përfitime. Së pari, provimet realizohen në mënyrë më të shpejtë dhe efikase, duke shmangur dokumentacionin tradicional dhe duke kursyer kohë si për mësuesit ashtu edhe për nxënësit. Gjithashtu, platforma sjell një vlerësim objektiv dhe të shpejtë për çdo nxënës/e, me rezultate që janë të aksesueshme menjëherë pas përfundimit të testimit. Përveç kësaj, MësoVET i mundëson mësuesit të analizojë të dhënat në detaje për të identifikuar pikat e forta dhe ato që kërkojnë përmirësim tek nxënësit, duke ofruar një qasje më të personalizuar në mbështetje të zhvillimit të tyre.

Kryerja e Provimeve të Nivelit përmes MësoVET ka krijuar një standard të ri të vlerësimit në shkollat profesionale, duke rritur transparencën dhe duke përmirësuar ndjeshëm cilësinë e vlerësimit të nxënësve. Duke parë këto përfitime dhe lehtësi, disa shkolla profesionale të mirënjohura për promovimin e digjitalizimit në arsim në Shqipëri, kanë realizuar edhe teste të tjera përmes Mësovet si provimet e drejtorisë, provimet praktike të nivelit për drejtimin Ekonomi-Biznes, si dhe kanë shtrirë më tej përdorimin e vlerësimit digjital në përditshmëri.

Për t'u njohur me shembuj të tjerë të përdorimit të platformave për vlerësimin e nxënësve, mund të gjeni [këtu](#) botimin “ Unë veproj kështu: Praktika të mira të digjitalizimit të mësimdhënies”.

## **II. Përdorimi i platformës Mësovet për vlerësimin e vazhduar të nxënësve**

### **II.1. Pse Mësovet është zgjedhja më e mirë për vlerësimin digjital**

Platforma Mësovet, siç është shpjeguar edhe në seksionin e mësipërm është shumë e përshtatshme dhe ofron të gjitha mundësitë për të realizuar vlerësimin digjital të çdo lënde. Një nga avantazhet kryesore të kësaj platforme, është fakti që ajo ofrohet në shqip dhe vetëm pak komanda janë në anglisht (kryesisht ato që nuk përdoren shumë).

Mësovet është shumë e përshtatshme për t'u përdorur, sepse ka shumë video tutoriale për ilustrimin e funksionimit të saj në përgjithësi, por edhe për veprimtari dhe nevoja të tjera të veçanta. Vlerësimi digjital në Mësovet lehtëson punën e mësuesit në disa drejtime si: krijimi i veprimtarive me vlerësim automatik (teste, kuice, sondazhe, forume, detyra); kategorizimi i veprimtarive dhe përlllogaritja e pikëve të tyre me një peshë specifike në vlerësimin përfundimtar, krijimi i kuiceve të shkurtër ose testeve duke përdorur Bankën e pyetjeve, ka një aplikacion të Mësovet etj.

Struktura e Mësimit të lejon organizimin e shumicës së veprimtarive mësimore brenda platformës, pa qenë e nevojshme të kalohet nga një aplikacion në tjetrin.

Mësimit ofron siguri maksimale përsa i përket saktësisë në korrigjim, ruajtjes së informacionit nga përdorues jo të autorizuar dhe rrit besimin edhe të nxënësve për barazi në korrigjim.

## II.2. Aftësitë e nevojshme digjitale të mësuesve për vlerësimin me anë të Mësimit

Siç u përmend edhe më sipër, Mësimit është një platformë miqësore me përdoruesin dhe një pjesë e mirë e komandave dhe shpjegimeve janë të përkthyer në shqip, gjë që e lehtëson shumë më tepër përdorimin e saj nga çdo mësues/e. Si rrjedhojë, niveli i aftësive digjitale të mësuesve mjafton të jetë bazë dhe do mund të orientohen në platformën Mësimit në realizimin e vlerësimit digjital.

Për të përcaktuar nivelin e aftësive digjitale, përgjithësisht përdoret rrjeti i vetëvlerësimit, i cili mbështetet në 5 fusha të kompetencës digjitale dhe tre nivele të aftësive: A (niveli fillestar ose bazik); B (niveli mesatar) dhe C (niveli i avancuar). Në rastin e përdorimit të Mësimit për vlerësimin digjital, nëse një mësues e ka të vështirë të përcaktojë nivelin e tij të aftësive digjitale, mund të bëjë një vetëvlerësim të shpejtë duke kthyer përgjigje me PO ose JO pohimet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	POHIMI për përdorimin e Mësimit për vlerësimin digjital	PO ose JO
1.	Unë jam në gjendje të krijoj/përdor llogarinë time.	
2.	Unë gjej lehtësisht kurset e mia.	
3.	Unë di të modifikoj elementë të caktuar të një kursi.	
4.	Unë mund të shtoj një veprimtari të re në një nga kurset/lëndët e mia.	
5.	Unë di të vendos disa parametra (pikëzim, koha e dorëzimit, punë në grup ose jo) të veprimtarive që shtoj në një kurs.	
6.	Unë di të përdor Bankën e pyetjeve.	
7.	Unë di të shtoj kategori të ndryshme në Bankën e pyetjeve.	
8.	Unë di të shtoj pyetje të reja në Bankën e pyetjeve në kategorinë përkatëse.	
9.	Unë di të krijoj një test, kuic me pyetjet nga Banka dhe tua shpërndaj nxënësve.	
10.	Unë di të përdor rubrikën Grades (Notat) për kursin tim.	

Nëse shumicës së këtyre pohimeve u jeni përgjigje me Po, atëherë për ju do të jetë shumë e lehtë të përfshini vlerësimin digjital në çdo lëndë tuajën. Nëse u jeni përgjigjur shumicës me Jo, mos u dekurajoni, por konsultohuni me këtë Manual, për t'u aftësuar edhe në ato elementë të përdorimit të Mësimit për vlerësimin digjital për të cilat ju duhet orientim.

## II.3. Përzgjedhja dhe krijimi i veprimtarive mësimore për vlerësimin e vazhduar (Forume, kuice, teste, detyra)

*II.3.a. Krijimi i Forum-eve me vlerësim.* Vendosja e parametrave të ndryshëm për një përdorim efikas të tyre në mësim dhe për vlerësimin.

Nga kontaktet me stafet e shkollave profesionale përdorues të platformës Mësovet, vihet re se “Forum-et” po bëhen një tjetër element vlerësimi i preferuar nga mësuesit. Duke qenë një hapësirë e përbashkët për diskutime dhe shkëmbim idesh, forumet kontribuojnë në interesimin e nxënësve dhe krijimin e një mjedisi ndërveprues ku ata mund të reflektojnë mbi tematikat e lëndës dhe të angazhohen realisht në procesin mësimor.

Në platformën Mësovet është e mundur të shtohen Forum-e, sipas kërkesave të lëndës dhe çështjeve që kanë nevojë për diskutime. Tipi i forumit të disponuar aktualisht në platformë është “*Forumi standard për përdorim të përgjithshëm*”. Këtu, çdo nxënës/e ka mundësi të fillojë një temë të re në çdo kohë. Nëse qëllimi juaj është nxitja e diskutimit mbi temën e shpjeguar dhe rritja e përfshirjes dhe ndërveprimit të nxënësve, ky lloj forumi është i duhuri, por është pak i vështirë për tu vlerësuar me pikë. Në këtë lloj forumi mund të zgjidhet vlerësimi pa pikë, por me detyrim plotësimin e tij nëpërmjet kontributit me një temë të re ose me komente mbi temat e hapura nga nxënës të tjerë.

#### **Video tutorial:**

- [Shtimi i një Forumi në Mësovet](#)

#### *11.3.b. Krijimi dhe shpërndarja e Kuiceve vlerësuese nëpërmjet platformës Mësovet*

Nga kontaktet me nxënësit mësojmë se Kuici është një nga aktivitetet më të preferuara të tyre në platformë. Pyetjet e shpejta dhe përgjigjet e menjëhershme të Kuicit e bëjnë atë tërheqës për nxënësit, të cilët e shohin si një mënyrë argëtuese dhe stimuluese për të provuar njohuritë e tyre. Formatu interaktiv i Kuicit ndihmon gjithashtu në zhvillimin e shpejtësisë së të menduarit dhe përmirëson kujtesën, ndërkohë që përmbush një funksion të rëndësishëm vlerësues. Nxënësit shijojnë veçanërisht ndjenjën e arritjes që vjen me përgjigjet e sakta dhe mundësinë për t’u krahasuar me shokët e tyre, duke krijuar një ambient pozitiv dhe konkurrues në mësim.

Kuicet në Mësovet krijohen shumë lehtë dhe mund të jenë të shumëllojshme. Puna lehtësohet më shumë, nëse më parë kemi krijuar një bankë pyetjesh, nga e cila mund të tërheqim pyetje sipas kapitullit/jve që jemi të interesuar, tipit të pyetjeve dhe numrit të tyre që do të përfshijmë. Përgjithësisht, lëndët e digjitalizuara në Mësovet dhe që janë të gatshme për tu përdorur nga mësuesit kanë një bankë pyetjesh, e cila mund të përdoret në rastin e kuiceve të shkurtër në bazë mësimesh ose kapitujsh dhe për teste më të gjatë. Çdo mësues ka mundësi të shtojë më shumë pyetje në bankë për t’i përdorur për këto qëllime.

Mësovet ofron mundësinë e vendosjes së disa parakushteve për kuicin/testin, që na ndihmojnë të organizojmë punën, të shmangim kopjimin, tu jepet të gjithëve kohë e barabartë për t’iu përgjigjur pyetjeve, vlerësimin automatik dhe pasqyrimin e pikëve në kategorinë përkatëse të vlerësimit të përgjithshëm të nxënësit. Në videon e mëposhtme demonstron se si të krijojmë një kuic në Mësovet, duke përdorur bankën e pyetjeve.

#### **Video tutoriale:**



- [Krijimi i një kuici në Mësovet duke përdorur bankën e pyetjeve](#)

### II.3.c. Krijimi i detyrave me vlerësim në platformë

Një nga kategoritë me vlerësim që mund të përdorim në Mësovet është edhe ajo e detyrave, të cilat do ua dërgojmë nxënësve nëpërmjet platformës sipas planit të lëndës. Detyrat shtohen si çdo veprimtari tjetër, duke klikuar mbi “shto një veprimtari ose material” dhe pastaj zgjedh “Assignment” dhe më pas vendosim përcaktimet për Detyrën që do u dërgojmë nxënësve.

Disa nga përcaktimet që Mësovet na lejon të modifikojmë janë: emërtimi, përshkrimi, kategoria ku do përfshihet, nëse do vendoset afati përfundimtar i dorëzimit, do e punojnë direkt në platformë apo do ngarkojnë materialet e punuara në dokumente të tjerë, pikët në total, punë në grup ose jo etj.

Për të krijuar një detyrë të re, e rëndësishme është që të plotësojmë ato fusha që janë të detyrueshme nga sistemi, ndërsa të tjerat mund t'i ndryshojmë edhe më vonë. Gjithsesi, rekomandohet që disa fusha të caktuara dhe me rëndësi për ecurinë dhe vlerësimin e nxënësve të plotësohen që në fillim, si p.sh. vlerësimi me pikë apo thjesht detyrimi për ta përfunduar, punë në grup apo individuale, ngarkim i materialit apo plotësim direkt në platformë, afati i dorëzimit.



Duke ditur paraprakisht këto elemente, nxënësit janë më të ndërgjegjësuar për vlerësimin që do të marrin nga detyra e dhënë dhe i kushtojnë rëndësinë e duhur. (Më lart, pamje ekrani për shtimin e një detyre të re në platformë).

**Video tutorial:**

- [Krijimi i një detyre në platformën Mësoret.](#)

### III. Banka e pyetjeve në Mësoret dhe përdorimet e saj

#### III.1. Çfarë është banka e pyetjeve në një platformë digjitale? *Avantazhet e përdorimit*

Banka e pyetjeve është një nga rubrikat në lëndët e krijuara në Mësoret, e cila lehtëson krijimin e testeve, kuiceve, sondazheve në çdo kohë dhe vend. Pavarësisht se mësuesit në këtë platformë i kanë lëndët të gatshme bashkë me bankën e pyetjeve, ata mund të vazhdojnë ta pasurojnë atë dhe ta përshtatin me pyetje sipas kategorive të ndryshme dhe niveleve të vështirësisë. Grupimi i pyetjeve në kategori (përkon me kapitullin) dhe nënkategori (përkon me temat e veçanta brenda kapitullit) e lehtëson edhe më tepër krijimin e testeve dhe kuiceve sipas qëllimeve specifike të mësuesit.

Ndër avantazhet e shfrytëzimit të rubrikës së Bankës së pyetjeve nga mësuesit përmendim:

- lehtësi për të krijuar teste dhe kuice të ndryshme për nga numri i pyetjeve, tipi dhe niveli i vështirësisë;
- pasurimi dhe modifikimi i vazhdueshëm i pyetjeve, sipas nevojave të mësuesit ose nxënësve;
- mundësia e bashkëpunimit midis mësuesve të së njëjtës lëndë, për të shkëmbyer pyetje dhe për të pasuruar bankën e pyetjeve.


#### III.1.a. Krijimi i bankës së pyetjeve në Mësoret dhe pasurimi i saj në vazhdimësi

Siç u përmend edhe më sipër, një nga avantazhet e përdorimit të Mësoret për vlerësimin digjital është edhe mundësia për të krijuar/përdorur Bankën e pyetjeve, të cilat i përzgjedhim për të krijuar teste ose kuice sipas planit tonë personal të zhvillimit të lëndëve. Pavarësisht nëse duam të zhvillojmë një test të shkurtër për mësimet e fundit apo një test përsëritjeje kapitulli, Banka e pyetjeve na ndihmon për t'i krijuar dhe për t'i shpërndarë ato me lehtësi tek nxënësit. Krijimi, modifikimi, fshirja e pyetjeve në Bankën e pyetjeve të platformës Mësoret është i thjeshtë dhe nuk kërkon aftësi të larta digjitale. Në [këtë video ilustruese](#) shpjegohet si krijohet një Bankë pyetjesh në Mësoret dhe kategoritë e tyre.


#### III.1.b. Si të hapim dhe përdorim Bankën e pyetjeve?

Bankën e pyetjeve e gjejmë gjithmonë brenda një lënde të caktuar në Mësoret dhe mund të aksesohet dhe kontrollohet vetëm nga ata që kanë të paktën rolin e mësuesit në atë lëndë. Pasi kemi zgjedhur një lëndë të caktuar dhe duam të përdorim bankën e pyetjeve, ka dy mënyra se si ta realizojmë këtë: a. Ose duke klikuar “More” (Më shumë) dhe pastaj “Question Bank” (Banka e pyetjeve) (si në pamjen e mëposhtme);





b. ose nëpërmjet faqes të kuicit të krijuar/ose që po krijohet duke klikuar në "Banka e pyetjeve" (si në ilustrim më poshtë).



**Kujdes:** Për të shtuar pyetje në një kuic, duhet të jeni në faqen e kuicit që po krijoni dhe të shtoni pyetje nga Banka prej atje, sepse nuk është e mundur të shtoni pyetje në një kuic duke qenë fillimisht në Bankën e pyetjeve.

### III.1.c. Organizimi i pyetjeve në Bankën e pyetjeve

Kur hapim Bankën e pyetjeve, na shfaqen në listë të gjitha pyetjet që ajo përmban. Për çdo pyetje në rresht ka disa të dhëna shtesë të vendosura në kolona. Ajo çfarë shfaqet në kolonat e pyetjeve të Bankës është në varësi të përzgjedhjeve paraprake të Administratorit të faqes së platformës, pra çfarë ka lënë ai të aktivizuar dhe çfarë jo. Në Mësovet, çdo pyetje ka të dhëna në kolonë të tilla si: Veprime, Statusi, Versioni, Comments, Usage, Last used, Modified by (ilustrimi i mëposhtëm).

MËSO VET Hapësira ime Kurset e mia Reports & Analytics Free Faqja kryesore

Questions

### Question bank

Select a category: Fillestare për Estetikë dhe marketing 12 (105)

The default category for questions shared in context 'Estetikë dhe marketing 12':

No tag filters applied

Filter by tags...

Show question text in the question list

Search options

Also show questions from subcategories

Also show old questions

Create a new question ...

Pyetje	Veprime	Status	Version	Created by Emri / Mbiemri / Date	Comments	Needs checking?	Facility index	Discriminative efficiency	Usage	Last used	Modified by Emri / Mbiemri / Date
<input type="checkbox"/> Pyetja 1	Ndrysho	Ready	v1	Irena Majko 27 korrik 2021, 17:20	0	-	N/A	N/A	0	Never	Irena Majko 27 korrik 2021, 17:22
<b>Treguesit e vlerësimit cilësor të pijeve freskuese ndahen në 2 grupe:</b>											
<input type="checkbox"/> Pyetja 1	Ndrysho	Ready	v1	Irena Majko 4 shtator 2021, 14:29	0	-	N/A	N/A	1	Never	Irena Majko 4 shtator 2021, 14:35

Forma [[1]] e vendosjes së tavolinave, realizohet për një numër mbi [[2]] persona.

Administratori rregullon dhe menaxhon kolonat me informacion rreth pyetjeve. Mësuesit që përdorin Mësovet në Bankën e pyetjeve mund të modifikojnë pyetjet në kolonën veprime, e cila ka disa opsione dhe mund t'i përcaktojnë statusin nëse do jete 'Ready', e gatshme për tu përdorur apo 'Draft', kur nuk është përfunduar së modifikuari.

### III.1.d. Çfarë përfaqësojnë kolonat në Bankën e pyetjeve dhe si përdoren



Më poshtë shpjegohet çfarë funksioni dhe informacioni kanë disa nga kolonat në Bankën e Pyetjeve dhe si përdoren?

1. Kolona **Veprimet** ju lejon të kryeni veprime të caktuara si redaktimi, dublikimi ose shikimi paraprak i pyetjeve. Ju gjithashtu mund të shikoni historikun e modifikimeve të një pyetjeje të veçantë dhe të shihni versionet e saj.
2. Nga kolona **Statusi** mund të shihni se cilat pyetje janë gati për t'u përdorur në kuicë dhe cilat kanë nevojë për kontroll nga kolegët. Nëse një pyetje është draft apo gati, mund të specifikohet gjatë krijimit të pyetjes, ose në këtë kolonë.
3. **Versioni (Version)** i referohet modifikimeve të ndryshme të asaj pyetjeje. Çdo herë që ndërhyjmë për të modifikuar një pyetje, shtohet numri te versionet. Për shembull, v3 nënkupton që pyetja është modifikuar 3 herë deri në atë moment.
4. **Ka nevojë për rishikim (Needs checking)** përcakton nëse një pyetje ka një problem dhe duhet rishikuar.
5. **Komentet (Comments)** u mundësojnë kolegëve të komentojnë një pyetje, si pjesë e procesit të rishikimit të kolegëve dhe sigurimit të cilësisë ose në rastet kur pyetjet bëhen në bashkëpunim.
6. **Përdorimi (Usage)** tregon numrin e kuicëve në të cilat përdoret një pyetje, me një lidhje me detaje më specifike.
7. **Përdorimi i fundit** tregon kur është përdorur për herë të fundit një pyetje.

### III.1.e. Organizimi i pyetjeve në kategori për lehtësi përdorimi

Në Bankën e pyetjeve fillimisht është vetëm kategoria 'Default' (e paracaktuar) dhe të gjitha pyetjet që krijoni vendosen automatikisht në atë kategori. Për të organizuar më mirë pyetjet dhe për të lehtësuar përdorimin e Bankës së Pyetjeve, platforma Mësovet na lejon të krijojmë kategori të veçanta. Përveç kategorive, mund të krijohen edhe nënkategori, për të lehtësuar më shumë punën dhe përdorimin e pyetjeve të rastësishme nga sistemi.

Për të shtuar ose modifikuar kategoritë e pyetjeve në Bankë klikojmë 'Kategoritë' (Categories) dhe më pas 'Shto kategori' (Add category).



Në video autorialin e mëposhtëm shpjegohet më qartë se si shtohet një kategori në Bankën e pyetjeve në Mësovet.

#### Video tutorial:

- [Shtimi i një kategorie në Bankën e pyetjeve të Mësovet](#).

#### III.1.f. Shtimi i pyetjeve të reja në Bankën e Pyetjeve

Pyetjet në Bankë mund të shtohen dhe modifikohen në çdo kohë. Një mësues mund të fillojë shtimin e një pyetjeje dhe ta vendosi në statusin *Draft* (Pa përfunduar), nëse nuk arrin ta përfundojë atë me

alternativat e duhura, apo për arsye të tjera. Duke i vendosur statusin *Draft* është më i orientuar edhe për të mos e përfshirë atë në kuicet e ardhshme derisa të jetë në statusin *Ready* (Gati).


#### Video tutorial:

- [Krijimi i një Banke pyetjesh në Mësoret;](#)
- [Shtimi i një pyetjeje të re në Bankën e pyetjeve;](#)
- [Modifikimi dhe fshirja e pyetjeve ekzistuese në Bankën e pyetjeve.](#)

### III.2. Llojet e pyetjeve për vlerësimin digjital

#### III.2.a. Llojet e pyetjeve që mund të shtojmë në Platformën Mësoret

Platforma Mësoret ofron mundësinë e shtimit të pyetjeve të llojeve të ndryshme, si për teste që po i krijojmë direkt, si për Bankën e pyetjeve. Kjo gjë ndikon që ajo të përdoret nga të gjitha lëndët pa problem. Duke qenë se platforma na e krijon këtë mundësi, sugjerohet që mësuesit, kur krijojnë pyetje të reja për një test ose për Bankën, t'i bëjnë ato sa më të larmishme dhe të mos mbeten vetëm në tipin e pyetjeve me 3-4 alternativa ose 'vërtetë'/'gabuar'. Kur klikojmë Krijo një pyetje të re (*Create a new question*) në dritaren dialoguese kemi 16 tipe pyetjesh si: Me zgjedhje të shumëfishtë (me alternativa) (*Multiple choice*); Vërtetë/Gabuar (*True/False*); Me bashkim (*Matching*); Përgjigje e shkurtër (*Short answer*); Ese (*Essay*); Tërhiq dhe vendos në tekst (*Drag and drop into text*); Zgjidh fjalën që mungon (*Select missing word*); Përshkrim (*Description*). (Pamje ekrani mbi llojet e pyetjeve që mund të shtojmë në Mësoret).



Videot tutorial të mëposhtme ju ndihmojnë për të praktikuar se si të shtoni pyetje të llojeve të ndryshme në Bankën e Pyetjeve të lëndës/ve tuaja në Mësoret.

#### Video tutorial:

- [Krijimi i pyetjeve me tre ose më shumë alternativa \(Alternatives\);](#)
- [Krijimi i pyetjeve me përgjigje Vërtetë/Gabuar \(True/False\);](#)
- [Krijimi i pyetjeve Me bashkim \(Matching\);](#)

- [Krijimi i pyetjeve Tërhiq dhe lësho](#) (Drag and drop);
- [Krijimi i pyetjeve Plotëso me fjalën që mungon](#) (Select missing word).

Llojet e tjera të pyetjeve, që ofron platforma mund t'i praktikoni vetë në vazhdim, duke ndjekur të njëjtën linjë dhe logjikë të pyetjeve në videot tutoriale. Në çdo rast, para sesa ta shtoni përfundimisht një pyetje në Bankë, kontrolloni me opsionin *Shikoj paraprakisht pyetjen* (Preview) ose ruajeni në versionin *Draft* derisa të jeni të sigurtë që është formuluar si duhet dhe është e gatshme për tu përdorur në test.

### III.3. Hartimi i pyetjeve që shmangin kopjimin në vlerësimin digjital

Një nga shqetësimet e mësuesve për vlerësimin digjital është se nxënësit mund të kopjojnë nga njëri-tjetri gjatë testeve apo kuiceve të shkurtra. Tek pyetjet që janë me alternativa, ekziston mundësia për të cilat nxënësit e kanë më lehtë të kopjojnë edhe nëpërmjet një komunikimi të shpejtë me shokët. Ndërkohë vlerësimi digjital automatik, kryhet vetëm me pyetje të tilla, pasi aplikacionet aktuale përgjithësisht ofrojnë vetëm këtë shërbim dhe më pak vlerësimin e pyetjeve formuese. Duke pasur parasysh këto problematika të shfaqura dhe duke dashur që të krijojmë teste, apo kuice ku të maten dijet reale për secilin nxënës, po listojmë më poshtë disa nga elementët kryesor për të hartuar pyetje apo teste që eliminojnë ose reduktojnë maksimalisht kopjimin nga ana e nxënësve.

- *Është e rëndësishme që të përgatiten lloje të ndryshme pyetjesh. Testi të mos jetë i gjithi me pyetje me alternativa, por të ketë edhe të paktën dy-tre pyetje formuese, të cilat do të diferencojnë nxënësit dhe që do të korrigjohen me dorë nga mësuesi.*
- *Një mënyrë tjetër për të shmangur kopjimin është edhe që të ketë sa më pak pyetje të bazuar në mbajtje mend dhe përsëritje të informacionit siç është në libër;*
- *Hartoni pyetje që u kërkojnë nxënësve të ilustrojnë marrëdhëniet midis koncepteve të mësuara dhe fjalëve kyçe (të krijojnë një hartë koncepti dhe ta shpjegojnë atë).*
- *Krijoni pyetje përmbledhëse të koncepteve kryesore të kapitujve që nxënësit edhe nëse punojnë me libër të hapur nuk do mundën të kopjojnë.*
- *Kërkojuni nxënësve të shkruajnë përgjigjet duke treguar procesin e zgjidhjes dhe parimet e zbatuara për përgjigjen e dhënë;*
- *Të përzgjidhet opsioni i renditjes së rastësishme të pyetjeve dhe alternativave nga sistemi; Në këtë rast është e rëndësishme që mësuesi të mos përfshijë alternativa të tilla si: Asnjë nga të mësipërmet; Të gjitha opsionet e mësipërme etj.*
- *Zgjidhni opsionin që pyetjet të dalin një e nga një dhe jo të gjitha njëkohësisht; Kjo e bën më të vështirë komunikimin e nxënësve për të njëjtën pyetje.*
- *Në disa raste mund të vendoset kushti që nxënësi të mos ketë mundësi të kthehet mbrapsht në pyetjet e mëparshme, pavarësisht nëse është përgjigjur ose jo. Kjo metodë do të ndikonte shumë në uljen e kopjimit, por do të ishte penalizuese për nxënësit, sepse mund të humbisnin pikë vetëm se kaluan gabimisht në pyetjen pasuese, shpenzojnë shumë kohë me një pyetje dhe nuk u del koha për të tjerat etj. Kjo metodë mund të eksperimentohet me kuice të thjeshta në përmbyllje të shpjegimit të mësimit dhe që nuk kanë shumë peshë në vlerësimin përfundimtar.*

### III.3.a. Disa këshilla për organizimin e përgjithshëm të vlerësimit digjital:

- *Përdorni metoda të tjera përveç testeve objektive.* Për të pasur një vlerësim më gjithëpërfshirës, si pjesë e vlerësimit digjital, përveç minitesteve, eseve, diskutimeve etj. mund të përdoren edhe pyetësorët, reflektimet, vetëvlerësimet ose vlerësimet e njëri-tjetrit etj.
- *Riorganizoni përqindjet e fituara nga llojet e ndryshme të vlerësimit digjital.* Për t'i dhënë më shumë mundësi vlerësimit të mendimit kritik, përgjigjeve logjike, formulimeve të sakta etj. është mirë që të rregullohet ndarja e përqindjeve në mënyrë që këto elementë në total të kenë më shumë sesa minitestet apo testet me pyetje të thjeshta. *Për shembull:* 35% e vlerësimit total të jetë nga testet, minitestet; 30% nga ese-të dhe pyetësorët me pyetje që kërkojnë argumentim; 25% reflektimet mbi koncepte të ndryshme dhe 10% për vetëvlerësimin dhe vlerësimin nga shokët e klasës.
- *Përfshini vlerësime formuese.* Jepni detyra të ndryshme gjatë orëve të mësimit dhe për vlerësimin përfundimtar llogarisni përmbledhjen e tyre dhe jo të bazoheni vetëm te rezultatet e një provimi në fund të kapitullit apo të gjithë lëndës;

### III.3.b. Përgatitja e testeve të ndryshme duke përdorur pyetjet nga Banka e Pyetjeve. Testet të shkurtra, testet e kapitujve, testet përfundimtare etj.

Siç është përmendur edhe më sipër, Banka e pyetjeve shërben për të krijuar shpejt teste, kuice sipas nevojave të mësuesit, madje edhe për përsëritjet përfundimtare.

Avantazh tjetër është që i njëjti test i krijuar mund të publikohet dhe të përdoret edhe në klasa të tjera ose në vitet e ardhshme. Le të shohim video për të mësuar praktikisht, se si të përdorim Bankën e pyetjeve për të krijuar teste ose kuice.

#### Video tutorial:

- [Përdorimi i Bankës së pyetjeve për krijimin e testeve të llojeve të ndryshme.](#)

## IV. Përdorimi i platformës Mësovet nga nxënësit për realizimin e veprimtarive të ndryshme me vlerësim

Në këtë sesion kemi vendosur tu kushtojmë vëmendje nxënësve dhe t'i orientojmë e tu japim ndihmë me anë të videove tutoriale për të përdorur pa problem platformën Mësovet për të realizuar detyrat dhe aktivitetet e ndryshme që postohen në të. Çdo veprimtari, kuic, test, detyrë, forum etj. që krijohet në platformë ka për qëllim përfshirjen e nxënësve dhe vlerësimin e punës dhe ecurisë së tyre, kështu që është e rëndësishme të sigurohem që edhe ata kanë ndihmën e duhur për ta përdorur sa më mirë platformën dhe të mos dështojmë në vlerësimin digjital, sepse nxënësit nuk dinë si të orientojnë gjatë një testimi me kohë të kufizuar, kanë ide të mira, por nuk dinë t'i shtojnë ato në një forum, nuk dinë të marrin pjesë në një pyetësor të dërguar nga mësuesi etj.

### IV.1. Hapja e aktiviteteve të ndryshme në Platformë dhe dorëzimi i tyre

Në Mësovet, mësuesit mund të postojnë aktivitete mësimore që përmbajnë ose jo elemente vlerësimi. Aktivitetet mund të gjenden në fillim të kursit ose të temës, në varësi të organizimit që i bën mësuesi lëndës së tij. Sugjerohet që aktivitetet të jenë të vendosura në temën të cilës i përkasin dhe të ketë sa më shumë larmishmëri. Disa nga aktivitetet që mësuesit shtojnë zakonisht në Mësovet dhe që mund të përmbajnë elemente vlerësimi janë Assignment; Debate; Forum ose Open Forum;

Quiz. Në videot ilustruese shpjegohet se si mund të hapni këto aktivitete, t'i plotësoni kërkesat e tyre dhe t'i dorëzoni. Gjithashtu, do të shpjegohen edhe disa nga vështirësitë që mund t'ju shfaqen dhe si t'i zgjidhni ato.

#### Video tutorial:

- [Hapja e një Assignment në Platformën Mësoret dhe dorëzimi pasi është përfunduar;](#)
- [Hapja e një Debati në Platformën Mësoret dhe pjesëmarrja në të;](#)
- [Pjesëmarrja në një Forum të lëndës dhe shtimi i informacionit ose pyetjeve në të;](#)
- [Plotësimi i një Kuici në Platformë dhe dorëzimi në kohë.](#)

### **IV.2. Zhvillimi i testeve në Platformë dhe dorëzimi i tyre. Vështirësitë që mund të hasen dhe si t'i shmangim**

Një provim, kuic apo aktivitet tjetër me vlerësim në Mësoret krijohet nga mësuesit dhe u shpërndahet nxënësve në kohën e përcaktuar prej tij. Nxënësit duhet të njoftohen paraprakisht nga mësuesit për strukturën e testit, nëse pyetjet do të shfaqen të gjitha njëherësh ose një e nga një, nëse nxënësi ka të drejtë të kthehet të rishikojë pyetjet të cilave u është përgjigjur, sa kohë kanë në dispozicion etj. Nëse mësuesi nuk i shpjegon elementët e mësipërm, është mirë që vetë nxënësit të pyesin për tu sqaruar, sepse ato ndikojnë në cilësinë e përgjigjeve dhe të rezultatit të testit. Në këto video tutorial do të shpjegohet se si nxënësit të zhvillojnë testin, kuicin apo detyra të tjera me vlerësim, të shpërndara nga mësuesi nëpërmjet platformës Mësoret dhe si ta dorëzojnë atë në kohë, si të shmangim problemet teknike si dhe elementë të tjerë të rëndësishëm.

### **IV.3. Kontrolli i vlerësimeve individuale në platformë**

Në platformën Mësoret edhe nxënësit kanë mundësi të shohin dhe kontrollojnë të gjitha vlerësimet që kanë marrë gjatë një lënde të caktuar. Ata mund të shohin të gjitha vlerësimet njëherësh, por mund t'i shohin edhe një e nga një dhe të lexojnë edhe komentet e mësuesve, nëse ka. Duke pasur këtë mundësi, nxënësit e kanë më të lehtë të kuptojnë ecurinë e tyre në atë lëndë, kapitujt ose çështjet ku kanë vështirësi, sa pikë ose përqindje kanë grumbulluar për vlerësimin përfundimtar etj. Në videot ilustruese do të mësoni se si të përdorni platformën Mësoret për të parë vlerësimet tuaja në lëndët që zhvillonin në shkollë, si ta shkarkoni si dokument në excel dhe mundësi të tjera.

#### Video tutorial:

- [Kontrollimi i vlerësimeve të marra nga aktivitetet e ndryshme në platformën Mësoret.](#)
- [Shkarkimi i vlerësimeve si një dokument excel.](#)

## **V. Pyetje të shpeshta**

### **1. Si mund të krijohet një test në platformën Mësoret për të vlerësuar njohuritë e nxënësve?**

Për të krijuar një test në Mësoret, shkoni te lënda përkatëse, zgjidhni opsionin “Krijo një veprimtari” dhe përzgjidhni “Quiz”. Më pas, mund të shtoni pyetje nga banka e pyetjeve ose të krijoni të reja sipas temës që dëshironi të vlerësoni.

### **2. Çfarë lloj pyetjesh mund të përdor për testet digjitale në Mësoret?**

Në Mësoret mund të përdorni pyetje me zgjedhje të shumëfishtë, pyetje Vërtetë/Gabuar, me

përgjigje të shkurtër, ese, dhe pyetje me bashkim. Për një vlerësim gjithëpërfshirës, është mirë të përdorni një miks tipologji pyetjesh.

### **3. Si mund të krijohet pyetje që shmangin kopjimin gjatë testit?**

Ju mund të përdorni renditjen e rastësishme të pyetjeve dhe alternativave, të vendosni pyetje formuese që kërkojnë analiza ose mendim kritik, dhe të caktoni kohë të kufizuar për çdo pyetje. Po ashtu, testet mund të strukturohen në mënyrë që pyetjet të shfaqen një nga një dhe të mos ketë mundësi për kthim prapa.

### **4. Si të përfshijë kategoritë e vlerësimit dhe të përcaktoj peshën e secilës për vlerësimin përfundimtar?**

Në Mësovet, te lënda përkatëse, shkoni te “Gradebook” (Libri i notave) dhe shtoni kategori të ndryshme për aktivitete si detyra, kuice, teste, etj. Për secilën kategori, përcaktoni përqindjen që do të ketë në notën përfundimtare, në varësi të rëndësisë që dëshironi t’i jepni secilës.

### **5. Çfarë të bëjë nëse nxënësit kanë vështirësi në përdorimin e platformës Mësovet?**

Për t’u ndihmuar nxënësve, mund të ofroni një seancë orientuese mbi përdorimin e platformës, të dërgoni udhëzime të shkruara ose video tutoriale të shkurtër për hapat kryesorë, si dhe të inkurajoni ata që të praktikohen me aktivitete të thjeshta përpara se të zhvillojnë një test ose detyrë.

### **6. Si mund të kontrollojë nëse nxënësit i kanë dorëzuar detyrat e tyre brenda afatit?**

Në platformën Mësovet, çdo detyrë dhe veprimtari ka një afat dorëzimi. Ju mund të shikoni statusin e dorëzimit për çdo nxënës, të verifikoni nëse është dorëzuar brenda afatit dhe të shikoni për komentet që nxënësit mund të kenë lënë.

### **7. Si të sigurohem që nxënësit e kuptojnë se si funksionon sistemi i pikëzimit në testet digjitale në Mësovet?**

Ju mund të përdorni një kuic praktik në fillim të kursit ose lëndës, duke përfshirë pyetje me shembuj të ndryshëm të pikëzimit. Gjithashtu, mund të shpjegoni kriteret e pikëzimit dhe të ndani me nxënësit një skemë të qartë se si do llogariten pikët për testet dhe detyrat e tjera.

### **8. Si të përdor Bankën e Pyetjeve në Mësovet për të krijuar një test?**

Për të krijuar një test nga Banka e Pyetjeve, fillimisht sigurohuni që pyetjet të jenë të organizuara në kategori sipas temës ose kapitullit. Pastaj, gjatë krijimit të një testi të ri, mund të importoni pyetjet nga këto kategori duke klikuar në “Add from question bank.”

### **9. Si mund të shmang problemet teknike gjatë zhvillimit të testeve?**

Për të minimizuar problemet teknike, sugjerohet të kryeni një test praktik me nxënësit për t’u siguruar që ata të kuptojnë se si të navigojnë në test. Gjithashtu, është mirë të kontrolloni që testet të jenë të përshtatura për të gjitha pajisjet, dhe të shpjegoni procedurat për rinisjen e testit në raste të ndërprerjeve të papritura.

### **10. Si mund të monitoroj rezultatet dhe progresin e nxënësve në Mësovet?**

Në Mësovet, te rubrika “Grades,” mund të shikoni përmbledhjen e pikëve për çdo nxënës, rezultatet për secilën veprimtari dhe të identifikoni fushat ku nxënësit kanë vështirësi. Kjo ju lejon



të analizoni ecurinë e përgjithshme dhe të përshtatni metodat e mësimdhënies sipas nevojave të klasës.

**Burimet e përdorura:**

1. <https://assess.com/what-is-digital-assessment/>
2. Wall, J. E. (2000). Technology-Delivered Assessment: Diamonds or Rocks? ERIC Clearinghouse on Counseling and Student Services.
3. <https://www.highedu.kyoto-u.ac.jp/connect/en/teachingonline/assessment.html> 2/8
4. <https://help.lafayette.edu/adding-and-using-forums-in-moodle/#:~:text=To%20add%20a%20forum%3A&text=Choose%20the%20Topics%20Block%20w here,as%20allowing%20students%20to%20post>
5. <https://www.infosysbpm.com/blogs/education-technology-services/how-does-digital-assessment-transform-learning.html#:~:text=Digital%20assessment%20allows%20educators%20to,to%20offer%20bett er%20assessment%20experiences>.
6. Center for the Promotion of Excellence in Higher Education, Kyoto University, "Educational Assessment".
7. <https://www.linkedin.com/advice/0/what-assessment-tools-platforms-improve-your-teaching-g8qnf>;
8. <https://www.weareteachers.com/best-tech-tools-for-student-assessment/>
9. <https://help.lafayette.edu/adding-and-using-forums-in-moodle/#:~:text=To%20add%20a%20forum%3A&text=Choose%20the%20Topics%20Block%20w here,as%20allowing%20students%20to%20post>
10. <https://teaching-resources.delta.ncsu.edu/moodle-gradebook/#system>